REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 72, datë 04.04.2018

PËR
DISA SHTESA E NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN NR. 53, DATË 25.06.2009 "PËR TRAJTIMIN E DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT", E NDRYSHUAR

Në bazë dhe për zbatim të pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar dhe nenit 13, të Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimit në Rregulloren "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar me vendimin e Bordit nr. 53, datë 25.06.2009, e ndryshuar, si më poshtë:

   i) Në nenin 30, të kësaj rregulloreje shtohen pikat 9 dhe 10 me përmbajtje:

   "9. Dëmi moral dhe ekzistencial nga dëmtime të tjera, konsiderohet dëmi i ardhur nga humbja e përkohëshme e aftësisë për punë.

   Humbja e përkohshme e aftësisë për punë përcaktohet nga raportet mjekësore për një periudhë deri 6-muaj."

   10. Vlera e dëmit moral dhe ekzistencial që përfiton personi i dëmtuar, sipas pikës 9 të këtij neni, llogaritet në përpjestim të drejtë me periudhën e humbjes së aftësisë për punë."

   ii) Tabela 1, e nenit 14, pika 2 "Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar", zëvendësohet më Tabelën 1, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Shtesat dhe ndryshimi në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", e ndryshuar, të botohet në fletoren zyrtare.

3. Shtesat dhe ndryshimi i miratuar me këtë vendim, do të zbatohen për ngjarjet e sigurimit të ndodhura nga data 1 korrik 2018 e në vazhdim.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 1 korrik 2018.

KRYETAR	**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**
Pajtim MELANI	**Ervin KOÇI**

Tabela 1

KOEFICIENTËT E LLOGARITJES SË SHUMËS SË KAPITALIZUAR

Mosha	Koef(M)	Koef(F)	Mosha	Koef (M)	Koef(F)
12	25.550018	26.145486	47	18.774074	20.006803
13	25.432819	26.048247	48	18.466902	19.718752
14	25.312256	25.947579	49	18.152351	19.422555
15	25.188716	25.843887	50	17.830358	19.118036
16	25.062081	25.736799	51	17.500653	18.805002
17	24.932737	25.626455	52	17.163117	18.483428
18	24.800822	25.512733	53	16.817773	18.153079
19	24.665721	25.395252	54	16.464946	17.813331
20	24.526553	25.273876	55	16.105244	17.463719
21	24.383413	25.148466	56	15.738729	17.103936
22	24.235901	25.018876	57	15.365411	16.733644
23	24.084097	24.884955	58	14.985398	16.352477
24	23.927835	24.746548	59	14.598131	15.96086
25	23.766699	24.603493	60	14.202851	15.559316
26	23.600507	24.455373	61	13.804365	15.149707
27	23.429304	24.302257	62	13.397978	14.729943
28	23.25266	24.143965	63	12.983442	14.30003
29	23.070838	23.98031	64	12.563445	13.861477
30	22.884102	23.811341	65	12.14107	13.416469
31	22.692016	23.637104	66	11.717264	12.965619
32	22.494592	23.457163	67	11.292666	12.509648
33	22.291837	23.271545	68	10.868184	12.049351
34	22.083525	23.080272	69	10.444063	11.585688
35	21.870089	22.883128	70	10.020339	11.119851
36	21.651075	22.68012	71	9.5976598	10.652867
37	21.426671	22.471245	72	9.1766922	10.186009
38	21.196842	22.256271	73	8.7579883	9.7205221
39	20.960254	22.034951	74	8.3430462	9.2576716
40	20.715558	21.80681	75	7.9334726	8.7990734
41	20.46265	21.571798	76	7.5300964	8.3461418
42	20.201203	21.329641	77	7.1336399	7.9004892
43	19.930677	21.080266	78	6.744754	7.4635969
44	19.652127	20.823378	79	6.3677405	7.038342
45	19.366591	20.558879	80	6.0077239	6.6279778
46	19.073903	20.286865			